



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

NR. REGJ. THEM. 148

DATA E REGJISTRIMIT 15.01.2019

NUMER VENDIMI 5934/1

DATA 04.02.2019

VENDIM

"NE EMER TE REPUBLIKES"

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, E PERBERE NGA:

MARINELA OSMANI – GJYQTARE

Sot me date 04.02.2019, mori ne shqyrtim kerkesen, qe i perket:

KERKUES:

Viron Bezhani, ne cilesine e Presidentit te Shoqates "Komiteti Olimpik Kombetar Shqiptar".

OBJEKTI:

Detyrimin e Sekretarit te Pergjithshem te Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar te me vere ne dispozicion te gjithe dokumentacionin ligjor, qe lidhet me transaksionet financiare, perfshire por pa u limituar, edhe te akteve mbeshetese e plotesuese te veprimtarise financiare dhe dokumentet perkatese te veprimtarise se KOKSH, si dhe me cdo veprim tjeter te kryer per 5 vitet e fundit.

Detyrimin e Mbajtesit te Thesarit te Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar, te me vere ne dispozicion te gjithe dokumentacionin ligjor, qe lidhet me transaksionet financiare, perfshire por pa u limituar edhe te akteve mbeshetese e plotesuese te veprimtarise financiare dhe dokumentet perkatese te veprimtarise se KOKSH, si dhe cdo veprim tjeter te kryer ne pese vitet fundit.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr.8788, date 7.5.2001, "Per organizatat jofitimprurese". Statuti i Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar, (KOKSH). Rregullorja e Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar, (K.O.K.SH).

Gjykata, ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te kerkeses dhe te akteve bashkelidhur saj;

VEREN

1. Me kerkese drejtuar Zyres se Regjistrimit te Organizatave Jofitimpruese, kerkuesi Viron Bezhani, ne cilesine e e pretenduar te Presidentit te Shoqates "Komiteti Olimpik Kombetar Shqiptar", kerkon: "Detyrimin e Sekretarit te Pergjithshem te Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar te me vere ne dispozicion te gjithe dokumentacionin ligjor, qe lidhet me transakcionet financiare, perfshire por pa u limituar, edhe te akteve mbeshtetese e plotesuese te veprimtarise financiare dhe dokumentet perkatese te veprimtarise se KOKSH, si dhe me cdo veprim tjeter te kryer per 5 vitet e fundit. Detyrimin e Mbajtesit te Thesarit te Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar, te me vere ne dispozicion te gjithe dokumentacionin ligjor, qe lidhet me transakcionet financiare, perfshire por pa u limituar edhe te akteve mbeshtetese e plotesuese te veprimtarise financiare dhe dokumentet perkatese te veprimtarise se KOKSH, si dhe cdo veprim tjeter te kryer ne pese vitet fundit".

2. Ai pretendon se nisur nga kjo cilesi ai legjitimohet ne paraqitjen e kesaj kerkese, e oja pretendon se ka per qellim vendosjen e aksesit te plote ne te gjithe dokumentacionin ligjor, qe ka shoqeruar transakcionet financiare, si dhe te veprimeve te tjera qe lidhen me administrimin e fondeve, dhe menyres se alokimit te tyre, nga organet dhe strukturat e Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar. Ne perfundim te kerkeses, kerkuesi kerkon urdherimin e Sekretarit te Pergjithshem te KOKSH, si dhe te Mbajtesit te Thesarit qe ti vene atij ne dispozicion te gjithe informacionin e kerkuar, bazuar ne Ligjin Nr.8788, date 7.5.2001, "Per organizatat jofitimpruese", Statutin e Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar dhe Rregulloren e Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar.

Ne lidhje me kete kerkese Gjykata veren se:

3. Ne regjistrin e organizatave jofitimpruese rezulton e regjistruar me vendimin Nr.5934, date 22.06.2018 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, Shoqata "Komiteti Olimpik Kombetar Shqiptar", me president palen kerkuese Viron Bezhani.

4. Ne vijim, ne nenin 20 te ligjit Nr.8788, date 07.05.2001 "Per organizatat jofitimpruese" parashikohet se: "Detyrat e organit me te larte vendimmarrës - Organi me i larte vendimmarrës i organizatës jofitimprurëse, përveç çështjeve të tjera që çmon se duhet të shqyrtohen prej tij, ka këto detyra: a) vendos për ndryshimin e statutit; b) përcakton fushat dhe programet e veprimtarisë, si dhe mbikëqyr e kontrollon rregullisht realizimin e tyre; c) shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit; ç) miraton pasqyrat financiare që paraqiten nga

organi ekzekutiv, ku jepen me hollësi burimet materiale e financiare, përdorimet e tyre dhe pasuritë e organizatës; d) miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e organizatës jofitimprurëse dhe shpenzimet për vitin e ardhshëm; dh) kontrollon rast pas rasti shpenzimet financiare të kryera nga organizata gjatë realizimit të veprimtarisë së saj, duke përfshirë edhe ato të kryera për veprimtari të përbashkëta me organizata të tjera; e) nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, të organizimit dhe të strukturës së organizatës; ë) zgjedh ose emëron dhe shkarkon anëtarët e organit më të lartë ekzekutiv; f) krijon komitete të posaçme; g) mbikëqyr veprimtarinë e organizatës jofitimprurëse, me qëllim parandalimin e përdorimit të burimeve të organizatës për qëllime terroriste, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; gj) vendos edhe për çështje të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj ose në statut."

5. Ndërsa, në nenin 22, parashikohet "Organi ekzekutiv: a) siguron mbarëvajtjen financiare të organizatës dhe ushtrimin e veprimtarisë së saj në përputhje me qëllimin e deklaruar; b) përfaqëson organizatën në marrëdhënie me subjektet, private ose publike, të tilla si donatorë, klientë furnizues apo subjekte të tjera private, si dhe me të gjitha nivelet e qeverisjes që rregullojnë veprimtarinë e organizatës; c) bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për të siguruar që organizatat partnere dhe ato që sigurojnë financim, shërbime dhe mbështetje materiale nuk përdoren apo manipulohen për qëllime terroriste."

6. Në vijim neni 17 të ligjit parashikohet: "Statuti - Rregullimi i hollësishëm i çështjeve të organizimit, të funksionimit dhe të veprimtarisë së organizatës jofitimprurëse parashikohet në statutin e saj. Statuti i organizatës jofitimprurëse hartohet nga themeluesit dhe miratohet në mbledhjen themeluese të organizatës. Në rastin e themelimit të fondacionit me testament, statuti mund të hartohet dhe të miratohet nga ekzekutori i testamentit, përveç rasteve kur testamenti e përcakton ndryshe. Statuti i organizatës jofitimprurëse duhet të përmbajë: a) formën e organizimit; b) emrin, siglën dhe simbolin e veçantë të organizatës; c) themeluesit; d) qëllimin dhe fushën e veprimtarisë së organizatës; e) ndalimin e shpërndarjes së fitimeve; dh) kohëzgjatjen; e) organet drejtuese dhe kompetencat e tyre; ë) përbërjen e organeve të para drejtuese, që parashikohen në statut; h) procedurat dhe mënyrat për zgjedhjen ose ndryshimin e organeve drejtuese; i) rregulla për mbajtjen e mbledhjes, pjesëmarrjen, mënyrën dhe procedurën e votimit për marrjen e vendimeve; j) kriteret e administrimit të pasurisë; k) mënyrën e miratimit të ndryshimit të statutit, të aktit të themelimit dhe të rregullave të brendshme; l) rregullat për bashkimin dhe ndarjen e organizatës jofitimprurëse; ll) mënyrën e përfaqësimit ligjor; m) rregullat për likuidimin dhe destinimin e pasurisë pas mbarimit të organizatës. Përveç sa përmendet në paragrafin e tretë të këtij neni, për shoqatën, statuti duhet të parashikojë edhe: a) rregullat për pranimin e përjashtimit të anëtarëve; b) të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve; c) rregullat lidhur me kuotizacionet. Përveç sa përmendet në paragrafin e tretë të këtij neni, për

fondacionin dhe qendrat, statuti duhet të parashikojë edhe burimet financiare dhe materiale të siguruara nga themeluesi dhe mënyrën e përdorimit të tyre.”

7. Në nenin 14 të Ligjit Nr. 79/2017 “Për sportin” parashikohet se: “Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar - 1. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar është person juridik, që organizohet dhe funksionon në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe kuadrit ligjor për organizatat jofitimprurëse dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me Kartën Olimpikë dhe statutin e tij të miratuar nga ministri përgjegjës për sportin, përpara kërkesës për regjistrim në gjykatën kompetente. 2. Lëvizja olimpikë drejtohet dhe bashkë-ndehet nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar. 3. Ndryshimet statutores miratohen nga ministri përgjegjës për sportin brenda 60 ditëve nga data e depozitimit. Pas kalimit të këtij afati, ndryshimet statutores konsiderohen të miratuara në heshtje. Pas përfundimit të kësaj procedure, ndryshimet statutores regjistrohen në gjykatë. 4. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar mund të financohet me fonde të dhëna nga Buxheti i Shtetit në formë transferte, si dhe burime të tjera të ligjshme. 5. Ministria përgjegjëse njihet vetëm një Komitet Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe asnjë organizatë tjetër nuk mund të ushtrojë atributet e këtij Komiteti. 6. Në Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar aderojnë federatat shqiptare, organizata të tjera sportive dhe persona juridikë dhe fizikë, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në statutin e këtij Komiteti. 7. Vendimet e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar bëhen publike nëpërmjet dërgimit zyrtar tek të gjithë anëtarët e tij.”

8. Nga sa më lart, duke patur në konsideratë kerkimin e pales kerkuese ne cilesine e Presidentit te Komitetit dhe te gjitha parashikimet sa me lart cituar, Gjykata arrin ne perfundimin se kerkesa nuk gjen mbeshtetje ne ligj. Ne Zyren e Regjistrimit te Gjykates mund te depozitohen te gjitha vendimet e organeve kompetente te shoqates, te cilat percaktohen si te regjistrueshme per ligji Nr.8789, date 07.05.2001 “Per regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.

9. Kerkesat me objekt te tille nuk kane baze ligjore sipas ketij ligji si dhe te ligjit Nr.8788, date 07.05.2001 “Per organizatat jofitimprurëse”, te ndryshuar, pasi ato parashikohen te zgjidhen ne edhe ne baze te statuitit te “Komiteti Olimpik Kombetar Shqiptar”, i cili rregullon kompetencat e organeve vendimmarrese dhe ekzekutive. Ne rast te shkeljeve te dispozitave Statutores nga nje nga organet ekzekutive, vendos mbledhja e pergjithshme e te gjitha anetareve, e cila ka kompetencen te zgjedhjes, shkarkimit dhe caktimit te kompetencave te tyre. Ajo vendos jo vetem per shkarkimin e anetarit nga detyra ne organin ekzekutiv, por dhe largimin e tij nga shoqata.

10. Gjykata ka per objekt vetem depozitimet e vendimeve dhe konfliktet qe krijohen midis shoqates dhe anetareve te saj si dhe te treteve, kur ketyre te fundit iu jane cenuar te drejtat e tyre nga vendimarrjet e Shoqates. Ne asnje dispozite te ligjit nuk parashikohet nderhyrja e Gjykates ne rast te konfliktit te kompetencave midis organeve ekzekutive te vete Shoqates. (shih ligjin Nr.8788, date 07.05.2001 “Per organizatat jofitimprurëse”).

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne nenet 24-53/1 te Kodit Civil, ligjin Nr.8788, date 07.05.2001 "Per organizatat jofitimprures", ligjin Nr.8789, date 07.05.2001 "Per regjistrimin e organizatave jofitimprures";


VENDOSI

1. Mospranimin e kerkeses se kerkuesit Viron Bezhani, si te pabazuar ne ligj.
2. Shpenzimet gjyqesore jane ne ngarkim te kerkuesit.
3. Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda 15 diteve nga dita e neserme e njoftimit te vendimit te arsyetuar ne Gjykatën e Apelit Tirane.

U shpall ne Tirane, me date 04.02.2019

GJYQTARE

MARINELA OSMANI

A large, stylized handwritten signature in black ink, appearing to be 'M' followed by several loops and a vertical stroke, positioned to the right of the printed name.